


Doganat tejkalojnë planin me 160 milionë USD për 10 mujorin

Të ardhurat për periudhën 10-mujore, janë realizuar në masën 154 miliardë lek nga 138.3 miliardë lekë të planifikuara ose rreth 15.8 Mld lek më shumë (rreth 160 Mln \$ më tepër). Në krahasim me 10 Mujorin 2020 janë realizuar rreth 30.3 miliardë lek më shumë (ose rreth 300 milionë USD më tepër).

Duhet vlerësuar se dhjetë mujori Janar-Tetor 2021 ka realizmin më të lartë të çdo 10-mujori në historinë e doganave, duke kaluar edhe të ardhurat e 10-mujori të vitit 2019 me rreth 18 milionë dollarë:



Sipas të dhënave zyrtare rreth 79% e rritjes së të ardhurave vjen si rrjedhojë e rritjes ekonomike, rritjes së fluksit të importit dhe mireadministrimit, ndërsa 21% si rrjedhojë e efektit të çmimeve.

Performanca 10 mujorit për taksat kryesore të mbledhura nga administrata doganore, krahasuar me një vit më parë është si vijon:

- Taksa Doganore, + 1 miliardë lek më shumë nga rifillimi i importit të mallrave me origjinë kryesisht Kinë;
- **Akciza, në total +6.3 Mld lek** që ka ardhur përgjithësisht nga: rritja e importit të karburantit me +3.4 Mld, rritja e importit të cigareve me +2.4 Mld, Birrës me rreth 216 Mln lek, etj...

- **TVSH, në total**, T.V.SH-ja krahasuar me dhjetë-mujorin 2020 ka dhënë rreth **22.7 Mld lek më shumë**, e stimuluar kryesisht nga:
 - **+3.5 mld** Lek rritja e Karburantit të importit
 - **+3.3 Mld** lek rritja e konsumit të mallrave të konsumit të përditshëm.
 - **+2.3 Mld** lek rritje nga importi i metaleve bazë.
 - **+1.8 Mld** lek rritje e importit të automjeteve të përdorura.
 - **+1 Mld** lek Energji elektrike
 - **+880 Mln** lek rritje e importit të veshje, tekstile.
 - **+870 Mln** Lek Konstruksionet metalike
 - **+850 Mln** lek Gaz i lengshem
 - **+760 Mln** lek Plastika dhe artikujt e saj,, etj....

- **Renta, me ndikim 468 Milion** lek për shkak të efektit të kombinuar midis rritjes së sasisë me rreth 31,000 ton dhe gati dyfishimit të cmimit mesatar dhjetë-mujor. Rreth 16 Mln lek plus janë siguruar nga mineralet e tjera.

Të njëjtën ecuri kanë edhe mallrat e akcizës në periudhën Janar-Tetor, **në konsum**, për periudhën 2016-2021 ku efetin më të madh e ka dhënë karburantet me 83 mijë tonë më shumë se e njëjta periudhë 10 mujore e vitit të kaluar ose rreth 20 mijë tonë më shumë se rekordi i mëparshëm i vitit 2019.

	Karburante në ton					
	2016	2017	2018	2019	2020	2021
Progr.	432,315	477,068	499,480	514,704	451,106	534,444

